



Raporti mujor mbi ndjekjen e Kapitullit 23 – gjyqësori, lufta kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore - shkurt 2017 -

I GJYQËSORI

1. Pavarësia

Përsëri rishpërndarje e gjykatësve në Gjykatën Themelore Shkup 1

Vazhdojnë rishpërndarjet në Gjykatën Themelore Shkup 1. Pas shpërndarjes së 9 gjykatësve në periudhën shtator-tetor 2016 nga kryetari i mëparshëm i Gjykatës, këtë shkurt u.d. kryetarja e Gjykatës Themelore Shkup 1 Tatjana Mihajlova mori vendim për rishpërndarje të rreth njëzet gjykatësve nga njësia e penale në atë ndëshkimore. Një pjesë e gjykatësve janë shpërndarë jashtë njësisë së tyre të mëparshme, kurse disa në pozita më të ulëta. Shumica e gjykatësve dorëzuan ankesa në Gjykatën e Lartë. Një pjesë e mediave e interpretojnë këtë lëvizje si goditje mbi pavarësinë e punës së gjykatës, duke pasur parasysh se gjykatësit që janë rishpërndarë kanë punuar lëndë të Prokurorisë Speciale Publike e cila ka histori të bashkëpunimit jashtëzakonisht të vështirë me Gjykatën.

Një pjesë e gjykatësve të rishpërndarë janë nga të rrallët që kanë marrë vendime pozitive në lidhje me kërkesat për bastisje apo për masën paraburgim të PSP-së, si dhe pjesë e 15 gjykatësve të cilët nëpërmjet një peticioni e kanë kritikuar punën e kryetarit të mëparshëm Vlladimir Pançevski. Me këtë numri i gjykatësve që janë rishpërndarë në Gjykatën Themelore Shkup nga shtatori 2016 deri më tani është 30. Gjykata ka reaguar për shkrimet e mediave duke thënë se është e habitur nga interesi i disa individëve mbi rishpërndarjen dhe shpalljen e pavërtetësive. U.d. kryetarja ka vepruar në suazat e autorizimeve të saj ligjore dhe të gjithë gjykatësit në Gjykatë janë zgjedhur si gjykatës në Gjykatën Themelore Shkup 1, dhe jo në njësi të veçanta.¹ Sipas Gjykatës, nuk bëhet fjalë për asnjë lloj “pastrimi” të gjykatësve “të papërshtatshëm”, por për një pjesë të aktiviteteve në suazat e Orarit vjetor.

Hapet procedura e PThP-së për rastin për keqpërdorim të mjeteve financiare në fushatën zgjedhore

Disa media shpallën se PThP-ja Shkup ka hapur procedurë kundër LSDM-së (duke u mbështetur në burimet të të njëjtës parti) për keqpërdorim të mjeteve financiare në fushatën zgjedhore për Zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Sipas mediave, Prokuroria Themelore Publike – Shkup ka hapur procedurë kundër një personi, organizator i fushatës zgjedhore dhe personave të tjerë”, si edhe kundër një personi juridik për veprën penale keqpërdorim të mjeteve për financim të fushatës zgjedhore. Në shpalljen e Prokurorisë Themelore është e qartë se bëhet fjalë për parti politike.² Informacionet janë shpallur

¹ <http://www.osskopje1.mk/Novosti.aspx?novost=591>

² <http://jorm.gov.mk/?p=3852>





pothuajse në të njëjtën kohë kur PSP-ja u dërgoi ftesa rreth 200 personave nga Ohri, kryesisht anëtarë dhe simpatizues të VMRO-DPMNE-së, që të japin deklaratë si dëshmitarë në suazat e procedurës parahetimore, ku sipas burimeve jozyrtare, hetohen donatorët dhe donacionet e VMRO-DPMNE-së mbi keqpërdorime eventuale lidhur me to.

PThP Shkup informoi se procedura është hapur që në vitin 2016 dhe se mbahet në mënyrë në josedleksionuese dhe në mënyrë të pavarur nga organet e tjera kompetente. Nga PThP-ja informojnë se veprojnë sipas fletëparaqitjes penale të dorëzuar nga institucioni kompetent. Veprat për të cilat është hapur procedura janë në lidhje me përdorimin e mjeteve të palejueshme gjatë fushatës zgjedhore dhe dhënien e të dhënave të rreme në raportet financiare. Sipas PThP-së deri më tani, janë mbledhur dokumentacioni material dhe dëshmitë relevante me shkrim, si dhe janë marrë në pyetje mbi 70 persona dëshmitarë.

Janë ngritur procedura parahetimore për vepra penale kundër zgjedhjeve

Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit informoi se po zbaton procedura parahetimore për përcaktim të ekzistimit të bazave të dyshimit për vepra penale të kryera në mënyrë të organizuar dhe keqpërdorimeve të autorizimeve zyrtare në ushtrimin e funksionit nga ish-funksionarë të lartë të MPB-së së RM-së dhe personave të tjerë fizikë dhe juridikë nga Shkupi, Kumanova dhe Strumica.³ Veprat për të cilat mbahen procedurat kinse janë kryer në vitin 2014 dhe 2016. Sipas, Prokurorisë ekzistojnë baza të dyshimit se personat kanë kryer ndikim mbi mënyrën e votimit nëpërmjet formave të ndryshme gjatë zgjedhjeve.

Paanësia

PSP-ja dorëzoi ankesë kundër veçimit të dëshmime në lëndën “Komuna Qendër”

PSP-ja informoi se Gjykata Themelore Shkup 1, duke vepruar për propozimin e tyre akuzues për dhunë në Komunën e Qendrës ka marrë vendim për veçim të një pjese të dëshmimeve të propozuara nga PSP-ja. PSP-ja e informoi publikun se në Gjykatën e Apelit Shkup është dorëzuar ankesë në lidhje me vendimin e Gjykatës për shkak të shkeljes thelbësore të Ligjit për Procedurë Penale.⁴

Prokuroret e PSP-së janë sanksionuar për mosrespektim të Gjykatës

Gjykatësja Tatjana Mihajlova e ka ndërprerë seancën gjyqësore për porositje dhe ushtrim të dhunës në Komunën Qendër, pasi prokuroret e PSP-së Katica Janeva dhe Fatime Fetai i dënoi me nga 2.000 euro për shkak të “mosrespektimit elementar të gjykatës”. Gjoha e parë prej 1.000 eurosh prokurores Fetai i

³ <http://jorm.gov.mk/?p=3872>

⁴ <http://www.jonsk.mk/2017/02/03/поднесена-жалба-против-издвојување-и/>





është shqiptuar pasi ajo e akuzoi gjykatësen Mihajlova për falsifikim intelektual në procesverbalin e seancës së mëparshme dhe se do të ngrejë procedurë penale kundër saj. Janeva mori të njëjtën gjobë pasi gjykatëses i theksoi se nuk i meriton titujt gjykatëse dhe u.d. kryetare e Gjykatës dhe se nuk di të mbajë procesverbal. Pastaj të dyja prokuroret e akuzuan përsëri gjykatësen për falsifikim intelektual për çka janë gjobitur edhe me nga 1.000 euro, ose gjobë të përgjithshme prej 4.000 eurosh.

Ky është rasti i parë në historinë e Gjykatës Themelore Shkup 1 që gjykatësi të gjobojë prokuror publik për mosrespektim të gjykatës. Nga PSP-ja shpallën se janë ankuar për vendimet e gjykatëses Mihajlova para Gjykatës së Apelit. Sipas Gjykatës, në historinë 72-vjeçare të institucionit nuk është dëshmuar një sulm i tillë mbi gjykatësen, Gjykatën dhe pushtetin gjyqësor në shtet.⁵ Gjykata e vlerësoi sjelljen e prokuroreve si arrogante dhe tërësisht joprofesionale dhe konsideron se Janeva dhe Fetai e kanë keqpërdorur të drejtën e fjalës dhe e kanë shkelur parimin e kodeksit të etikës së prokurorisë publike.

Kompetenca

Këshilli Gjyqësor e përmbush standardin MKS MKC EN ISO 9001:2015

Gjatë vitit 2016 Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë e ka vendosur standardin MKS EN ISO 9001:2015 – Sistemi për menaxhim me cilësi – Kërkesa. Nga Këshilli informojnë se nga trupi i certifikuar INTERCERT është kryer kontroll në dhjetor të vitit 2016 dhe është konstatuar se Këshilli Gjyqësor e plotëson standardin MKS EN ISO 9001:2015.⁶

Këshilli Gjyqësor – seanca e 245-të⁷, 246-të⁸ dhe 247-të⁹

Këshilli Gjyqësor mbajti tri seanca ku janë marrë më tepër vendime për përfundim të funksionit gjykatës porotë dhe kjo në shumë gjykata themelore nëpër shtet, si dhe vendime për zgjedhjen e gjykatësve porotë të rinj. Është kryer shqyrtim dhe vlerësim i raporteve të punës së gjykatave në Republikën e Maqedonisë për tremujorin e katërt për vitin 2016. Është konstatuar se gjykatat kanë punuar në mënyrë efikase dhe se e kanë përballuar fluksin e lëndëve.

PSP-ja kërkon përfshirje në trajnimet e Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë

PSP-ja ka dërguar kërkesë në Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë “Pavle Shatev” për thellim të bashkëpunimit. Në këtë kërkesë PSP-ja thekson se Akademia në bazë të obligimeve të përcaktuara

⁵ <http://www.osskopje1.mk/Novosti.aspx?novost=592>

⁶ <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=494>

⁷ <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=491>

⁸ <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=493>

⁹ <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=496>





me ligj ka për detyrë të realizojë bashkëpunim profesional edhe me këtë Prokurori Publike dhe ta përfshijë në trajnim njëjtë si dhe prokuroritë e tjera publike.¹⁰

Procedura gjyqësore më të rëndësishme

“MITO”

Më 23.02.2017 është caktuar gjykimi “Mito” – KOK 62/16, ku si i akuzuar është z. Zoran Zaev për veprën penale “Marrje mitoje”. Debatimi është shtyrë për shkak të mungesës së të akuzuarit. Për këtë mungesë, nga mbrojtësi i të akuzuarit janë dorëzuar dëshmi, të cilat gjykata kërkoi të përkthehen në maqedonisht dhe të dorëzohen përsëri në gjykatë. Gjithashtu, nga gjykata mbrojtësve u është dorëzuar, ndërkohë, edhe vendim për tërheqje të prokurorit publik për këtë lëndë. Diskutimi i ardhshëm është caktuar më 03.04.2017.

“KOMUNA QENDËR”

Më 22.02.2017 u mbajt seanca për lëndën e njohur si “Komuna Qendër” ku si i akuzuar është z. Nikolla Gruevski së bashku me 15 bashkëpunëtorë të tij për veprën penale “Dhunë”. Para fillimit të debatit, gjykatësja e cila e gjykon këtë lëndë është akuzuar për “falsifikim intelektual” nga PSP-ja për shkak të ndryshimeve në procesverbalin me shkrim të cilat nuk korrespondojnë me atë që është thënë në seancën paraprake, përkatësisht që është në regjistrimet audio-vizuale të debatit.¹¹ Pas kësaj të dyja prokurorët e PSP-së janë gjobitur me gjoba në të holla me nga 2.000 euro për shkak të mosrespektimit të Gjykatës. Përfaqësueset e PSP-së insistuan që ta realizojnë të drejtën e tyre ligjore dhe të marrin një ekzemplar të filmimit që ta dëshmojnë pohimin e tyre dhe të ngrenë paraqitje penale kundër gjykatësit të gjykimit. Pas marrjes së vendimeve për gjobitje të prokurorëve, gjykata e dorëzoi të gjithë lëndën te Këshilli i Prokurorëve Publikë sipas “analogjisë” se ky Këshill është përgjegjës dhe mbikëqyrës për punën e PSP-së.

“Zoran Bozhinovski”

Më 22.02.2017 është mbajtur gjykimi për lëndën KOK-79/16, ku si i akuzuar për veprat penale “Shoqërim kriminel” dhe “Spiunim” është gazetari Zoran Bozhinovski. Në këtë gjykim është marrë në pyetje i dëmtuari si dëshmitar i prokurorisë, i cili në dëshminë e tij u drejtohej disa korrespondencave, për të cilat i akuzuari reagoi menjëherë dhe kërkoi të dorëzohen si dëshmi, megjithatë në mungesë të posedimit të dokumenteve në origjinal, propozimi është refuzuar. I akuzuari kërkoi, gjithashtu, t’i lejohet

¹⁰ http://www.jonsk.mk/wp-content/uploads/2017/02/Dopis_ASJO.pdf

¹¹ <http://all4fairtrials.org.mk/wp-content/uploads/2017/02/%D0%9A%D0%BE%D0%B3%D0%B0-%D1%81%D1%83%D0%B4%D0%BE%D1%82-%D0%B5-%D0%BE%D0%B1%D0%B2%D0%B8%D0%BD%D0%B5%D1%82.pdf>





shqyrtim i lëndës në prani të avokatit, për të cilën gjykata u përgjigj se do ta mundësojë deri në fillim të seancës së ardhshme. Është vënë re se gjykatësja e gjykimit gjatë dhënies së dëshmisë nga dëshmitari sillej si të ishte në fuqi Ligji i vjetër për procedurë penale. Me ligjin e ri LPP u ndryshua natyra e procedurës penale e cila nga inkvizuese u shndërrua në procedurë akuzuese, që do të thotë se gjykatësit duhet të jenë në rolin e arbitrave neutralë dhe të kenë kujdes për zbatimin e procedurës. Është vënë re se gjykatësja bënte lëshime nga autorizimet e veta që të intervenojë me kërkesë për sqarim të një pjese të dëshmisë së dëshmitarit, d.m.th. intervenimet e saj ngjasoni me pyetje të cilat e drejtonin dëshmitarin. Gjykimi i ardhshëm është vendosur të mbahet më 06.03.2017.

“Lagjja e trimave”

Seancat për lëndën KOK nr. 127/15 e njohur në publik si “Lagjja e trimave” gjatë këtij muaji ishin të hapura për publikun dhe pyeteshin të akuzuarit. Në seancën e fundit të mbajtur është marrë në pyetje i akuzuari i tretë për fakte dhe rrethana të cilat lidhen me kohën dhe vendin për të cilën supozohet se është kryer vepra. Në këtë lëndë të akuzuarit gjykohen për veprat penale “Terrorizëm” dhe “Organizata terroriste”. Seancat e ardhshme janë caktuar për më 03, 09, 13, 17, 21, 23 dhe 29.03.2017.

II LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Procedurë e re hetimore e PSP-së “TRUST”

PSP-ja e prezantoi para opinionit procedurën e re hetimore kundër personave juridikë “Transmet”, “Sileks nemetali ST” dhe “BATO” nga Studeniçani për falsifikim të dokumenteve për pjesëmarrje në tender të Elektranave të Maqedonisë (ELEM).¹² Sipas prokurores Fatime Fetaj, hetimi i ri do të dëshmojë deri ku ka vajtur lufta për fitim të tenderëve dhe se si konzorcium me dokumentacion të falsifikuar ka fituar tender dhe aneks marrëveshje me vlerë prej 1.060.000.000 denarë ose 17.235.772 euro. Hetimi është ngritur prej tri bisedave, prej të cilave dy nuk janë shpallur, kurse bëhet fjalë për nxjerrje të qymyrit në Suvodoll, Manastir për nevojë të KME-Manastir, gjatë së cilës të dyshuar janë drejtuesi i Transmet, i dyshuari i dytë është drejtuesi i “Sileks nemetali” dhe drejtuesi “Vago sh.p.k.” – Studeniçani të cilat kanë bërë marrëveshje me ELEM. Të dyshuarit ngarkohen për falsifikim të dokumentacionit të tenderit në bazë të të cilit e kanë fituar tenderin dhe kanë fituar dobi pronësore të paligjshme. Prokuroria dorëzoi kërkesë për paraburgim të Sead Koçan, pronarit të firmës “Transmet” dhe për Vasilije Aviroviq, ish-drejtuesin e “Sileks nemetali ST”, i dyshuari i parë dhe i dyshuari i dytë në këtë rast. Sipas SPS-së, ekziston rreziku që të dyshuarit t’i shkatërrojnë dëshmitë ose të krijojnë falsifikim në dokumentacionin e tenderit.

¹² <http://www.jonsk.mk/2017/02/28/%D0%B8%D0%B7%D1%98%D0%B0%D0%B2%D0%B0-%D0%BE%D0%B4-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D1%81-%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D1%84%D0%B5%D1%80%D0%B5%D0%BD%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0-2/>





Rasti “Erazmus”

Gjykimi për rastin “Erazmus” është mbajtur më 22.02.2017. Janë akuzuar gjashtë profesorë të Fakultetit Ekonomik në Shkup, për veprat penale “Marrje mito”, “Marrje shpërblim për ndikim të paligjshëm”, “Keqpërdorim të pozitës dhe autorizimeve zyrtare” dhe “Dhënie mito”. Gjykimi është shtyrë me arsyetim për gjendje të përkeqësuar shëndetësore të një prej të akuzuarve në procedurë, për çka është dorëzuar edhe dokumentacion mjekësor.

Zgjerohet hetimi për lëndën “TITANIK”

Prokurorja Katica Janeva nga PSP-ja informoi se zgjerohet hetimi për rastin “Titanik” ku deri më tani të dyshuar ishin 17 persona gjithsej. Midis tyre ka dhe të dyshuar të rinj, kurse disa tashmë janë pjesë e hetimit, por u vendosen si barrë edhe vepra të reja penale. Në “Titanik” janë të dyshuar ish-funksionarë të lartë të VMRO-DPMNE-së për parregullsi në zgjedhje.

Deputetë të cilët në të njëjtën kohë janë ministra kanë dorëzuar fletë pronësie të ndryshme në KShNK

Deputetët e rinj e respektuan obligimin ligjor për dorëzim të fletanketave dhe deklaratave mbi gjendjen pronësore në KShNK. Megjithatë, disa prej deputetëve kanë dorëzuar fletankete si ministre, kurse nga këto fletankete mund të shihet mospërputhja e të dhënave të dorëzuara në dy fletanketat.¹³

III TË DREJTAT THEMELORE

Liria e shprehjes dhe pluralizmi në media

Më 28 shkurt, gjatë tubimit të qytetarëve “Për një Maqedoni të përbashkët” është sulmuar një pjesë e ekipit të gazetarëve të medias elektronike A1ON. Një gazetar dhe një kameraman janë sulmuar me “grushte në kokë dhe nëpër trup”, kurse një pjesë e demonstruesve e thyen kamerën e tyre. Meqenëse “organizatori i protestës” nuk arriti t’i mbrojtë punëtorët e mediave” nga A1ON paralajmëruan se do të dorëzojnë fletëparaqitje kundër iniciativës “Për një Maqedoni më të mirë” dhe “do të kërkojë kompensim për dëmin nga sjellja primitive dhe e egër”.

Me reagime për dënim të sulmit dhe kërkesë për ndjekje të kryerësve, u paraqitën shumë institucione që punojnë në fushën e mediave. Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale të mediave, e dënojnë rreptësisht sulmin, duke theksuar se: “Siguria dhe jeta e profesionalistëve të mediave në asnjë rast nuk duhet të rrezikohen. Përkundrazi, ata duhet të lejohen të informojnë pa pengesa mbi të gjitha evenimentet dhe ngjarjet sidomos në momente shoqërore-politike që janë me rëndësi të

¹³http://www.dksk.org.mk/imoti_2/index.php?search=2&ime=%D0%9D%D0%B8%D0%BA%D0%BE%D0%BB%D0%B0&prezime=&funkcija=&institucija=





jashtëzakonshme”.¹⁴ Këshilli për Etikë në Media i Maqedonisë e dënoi ngjarjen e ndodhur duke theksuar: “Ky nuk është një incident i izoluar, kurse trendi i dhunës dhe i pengimit të punës së gazetarëve dhe punonjësve në media vazhdon të jetë një problem serioz”.¹⁵ Kryetari i Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, Naser Selmani, përgjegjësini për këtë incident ia hedh liderit të VMRO-DPMNE-së, Nikolla Gruevskit. Duke kujtuar se gjatë sundimit të Gruevskit, në burg kanë qenë dy gazetarë, ka pasur 40 sulme mbi gazetarët dhe është mbyllur televizioni A1.

Nga Ministria e Punëve të Brendshme janë arrestuar 12 persona me dyshim për ushtrim të dhunës ndaj gazetarit dhe kameramanit të A1ON, kurse Agim Nuhiu, ministri i punëve të brendshme theksoi se: “Do të dënohen të gjitha përpjekjet për prishje të rendit dhe qetësisë publike. U bëj thirrje të gjithë qytetarëve të të përmbahen nga çdo lloj dhune dhe shkeljeje të vlerave ligjore dhe kushtetuese”.

E drejta e shoqërimet

Në deklaratën e 28 janarit 2017 të VMRO-DPMNE-së thuhet se: “LSDM-ja dhe SOROS-i kanë shpresuar se me para dhe me ndihmë nga jashtë do të luajnë me vullnetin e popullit, do të arrijnë te pushteti dhe do të vazhdojnë me marshin e vet shkatërrues, duke kaluar pa u dënuar. Më 11 dhjetor, populli u dha fund fantazive të tilla të zymta të LSDM-së dhe të SOROS-it”.¹⁶ Lideri i kësaj partie, Nikolla Gruevski, deklaroi se: “Do të luftojmë për desorosoizim të Republikës së Maqedonisë dhe për përforcim të sektorit të pavarur qytetar i cili nuk do të jetë nën ndikimin e askujt. Do të kryhet rregullim i fushës së funksionimit të organizatave joqeveritare sipas shembullit të demokracive më të përparuara në botë”.¹⁷

Ky ambient i armiqësisë politike ndaj një pjese të grupeve shoqërore në shoqërinë qytetare maqedonase, në shkurt shkaktoi nevojë të reagimit të përbashkët të 127 shoqatave të qytetarëve, me të cilën theksohet “nevoja për mbrojtje, ruajtje dhe përparim të shoqërisë qytetare, përkundrejt kërcënimeve ndaj saj, por dhe t’i hedhim poshtë sulmet dhe gënjeshttrat e pabazuara”. Nevoja për mbrojtje të shoqërisë qytetare nënkupton, “mbrojtje të bashkëjetesës me përfaqësues të ndryshme etnike, mbrojtje e përpjekjeve për një standard jetësor më të lartë, mbrojtje të luftës kundër korrupsionit, mbrojtje të gjykimit të drejtë, mbrojtje të lirisë që të themi publikisht atë që e mendojmë, mbrojtje e trajtimit të barabartë në spitale, mbrojtje të arsimit ku askush nuk do të diskriminohet, mbrojtje të solidarizimit dhe ndihmës që e japim apo e marrim nga qytetarët tanë”.¹⁸

Krim prej urrejtjes

¹⁴ http://www.avmu.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=3161%3A-1&catid=88%3Asoopstenija-media&Itemid=313&lang=mk

¹⁵ <http://semm.mk/2015-05-23-11-45-15/259-soopstenie-01-03-17>

¹⁶ <http://vecer.mk/makedonija/vmro-dpmne-sleduva-vreme-na-desoroizacija>

¹⁷ <http://mk.voanews.com/a/macedonia-politics/3694205.html>

¹⁸ <http://soros.mk/mk/Home/NewsAndActivity?newsID=7291&catID=7>





network23@epi.org.mk

Këtë rishikim e përgaditën anëtarët e Rrjetit 23+, i cili vepron në fushat e përfshira me Kapitullin 23 nga aderimi në BE, gjyqësori dhe të drejtat themelore.



Gjatë këtij muaji Komiteti i Helsinkit ka regjistruar 17 vepra penale prej urrejtjes¹⁹ prej të cilave 14 incidente kanë ndodhur në Shkup, 2 në Prilep dhe 1 në Manastir. Janë sulmuar dhe lënduar dhjetëra të rinj, kurse janë sulmuar me gurë 8 shtabe të partisë politike LSDM. Incidentet ku janë sulmuar të rinjtë ndodhën në qendër të Shkupit (rruga Maqedonia, Qendra e transportit, BPRM, Stadiumi i qytetit) dhe stacionet e autobusëve ku ndalojnë autobusët e NTP-së. Incidentet përfshijnë goditje me gur të autobusëve, rrahje në grup, por edhe sulme serioze me armë të ftohtë. Shtabet e partisë LSDM janë goditur me gurë në Shkup, Prilep dhe Manastir. Goditja me gurë ka ndodhur në mbrëmje, përkatësisht pas mesnatës.

¹⁹ www.zlostorstvaodomraza.mk

